

NDËRLIDHJA MES VARËSISË NGA INTERNETI ME KËNAQSHMËRINË
NGA JETA DHE VETMINË TEK NXËNËSIT E KLASËS SË 12-TË TË
KOMUNËS SË PRIZRENIT

TEMA PËR TITULLIN
MASTER I ARTEVE NË DREJTIMIN PSIKOLOGJI SHKOLLORE DHE
KËSHILLIM

NGA

SIBEL VEZAJ



UNIVERSITETI I PRISHTINËS
FAKULTETI FILOZOFIK
DEPARTAMENTI I PSIKOLOGJISË
PRISHTINË

QERSHOR, 2021

Ndërlidhja mes varësisë nga interneti me kënaqshmërinë nga jeta dhe vetminë tek nxënësit e klasës së 12-të të Komunës së Prizrenit

Kandidatja: Sibel Vezej Pirana

Mentore: Prof. Ass. Kaltrina Kelmendi

Qëllimi i këtij hulumtimi është të shqyrtojë ndërlidhjen në mes të varësisë nga interneti me kënaqshmërinë nga jeta dhe vetminë. Ky studim ofron informacione në lidhje me pasojat negative të përdorimit të tepruar dhe të pakontrolluar të internetit, i cili mund të çojë në varësi. Po ashtu në këtë studim janë elaboruar faktorët të ndryshëm që lidhen me varësinë nga interneti, si koha e kaluar që nga fillimi i përdorimit të internetit, kohëzgjatja ditore e përdorimit të internetit dhe qëllimi i përdorimit të internetit. Varësia nga interneti është një nga fenomenet që ndikon tek adoleshentët, sidomos gjatë kohës së tashme, kur interneti ka hyrë në jetën e gjithsecilit. Andaj rezultatet e këtij hulumtimi janë të rëndësishme, meqë paraqesin një pasqyrë të nivelit të përdorimit të internetit, e në veçanti të varësisë nga interneti në mesin e adoleshentëve në vendin tonë, duke përçuar edhe interesimin e akterëve të ndryshëm dhe politikbërësve për të marrë me seriozitet rrezikun që mund të shkaktohet si pasojë e kësaj varshmërie biheviore.

Hulumtimi është shkruar në 80 faqe, në të cilat përfshihen Kapitulli I, ku është paraqitur hyrja dhe konteksti i studimit, arsyetimi, qëllimi dhe objektivat e studimit, si dhe fokusi dhe kufizimet e studimit; Kapitulli II, ku është paraqitur korniza teorike dhe shqyrtimi i literaturës për variablat, varësia nga interneti, vetmia dhe kënaqshmëria nga jeta; Kapitulli III, ku është paraqitur metodologjia e hulumtimit, përkatësisht mostra, instrumentet, dizajni dhe procedura, Kapitulli IV ku janë paraqitur rezultatet e studimit, si dhe Kapitulli V, ku është paraqitur diskutimi dhe rekomandimet, si dhe në fund burimet dhe shtojcat që përshijnë instrumentet matëse të këtij hulumtimi.

Kapitulli i parë fillon me paraqitjen e kontekstit teorik, përshkrimin e variablave, paraqitjen e problemit dhe qëllimit kryesor të studimit. Më pas janë paraqitur pyetjet kërkimore dhe hipotezat e hulumtimit:

1. A kanë ndërlidhje varësia nga interneti me nivelin e perceptuar të vetmisë?
2. A kanë ndërlidhje varësia nga interneti me kënaqësinë me jetën?

3. A ka ndërlidhje mes kohëzgjatjes së përdorimit të internetit me varësinë nga interneti
4. A ka ndërlidhje mes kohës së kaluar që nga fillimi i përdorimit të internetit me varësinë nga interneti?
5. A ka dallime gjinore në varësinë nga interneti?

H1: Varësia nga interneti ka ndërlidhje pozitive me nivelin e përceptuar të vetmisë

H2: Varësia nga interneti ka ndërlidhje negative me kënaqësinë me jetën

H3: Varësia nga interneti ka ndërlidhje pozitive me kohëzgjatjen e përdorimit të internetit

H4: Varësia nga interneti ka ndërlidhje pozitive me kohën e kaluar që nga fillimi i përdorimit të internetit

H5: Te meshkujt varësia nga interneti është më e lartë se te femrat

Po ashtu në këtë kapitull janë përfshirë arsyetimi, qëllimi dhe objektivat e studimit, si dhe fokusi dhe kufizimet e studimit.

Kapitulli II paraqet sfonde teorike për secilën prej variablave, varësinë nga interneti, vetminë dhe kënaqshmërinë nga jeta. Po ashtu në këtë kapitull është paraqitur shqyrtimi i literaturës për hulumtimet që janë realizuar për të shqyrtuar ndërlidhjen e variablave të lartpërmendura.

Në **Kapitullin III** është paraqitur metodologjia e hulumtimit, përkatësisht mostra, e cila përbëhet nga 466 nxënës të tre shkollave të mesme të larta të Komunës së Prizrenit, përkatësisht të klasave të 12-të, pastaj janë paraqitur instrumentet matëse ku janë përfshirë formulari për pyetje demografike, pyetësi për Varësinë nga Interneti (Young, 1996), pyetësi për vetminë Ucla (Russel, Peplau & Ferguson, 1978) dhe pyetësi për Kënaqshmërinë me Jetën (Diener, Emmons, Laresen & Griffin, 1985). Po ashtu është paraqitur dizajni korrelacional dhe metoda kuantitative e hulumtimit, si dhe është përshkruar procedura e mbledhjes së të dhënave.

Kapitulli IV përmban rezultatet e studimit, të cilët janë të paraqitura në tabela dhe figura. Në bazë të rezultatet të testit të normalitetit, është gjetur se ekziston shpërndarje jo normale të të dhënave, andaj edhe analizat janë bërë me analiza jo-parametrike, ku për të parë ndërlidhjen në mes të variablave është përdorur korrelacioni i Spearmanit, ndërsa për të parë dallimet ndërmjet grupeve është përdorur testi Mann-Whitney.

Në tabelën e parë të rezultateve janë paraqitur të dhënat e përgjithshme descriptive të pjesëmarrësve, ndërkaq më pas janë paraqitur tabelat për vitet që kanë kaluar që nga fillimi

përdorimit të internetit, ku mesatarja është 5-6 vite, si dhe për kohëzgjatja e kaluar në internet për një ditë, ku po ashtu mesatarja është 5-6 orë në ditë. Në rezultate janë paraqitur edhe faktorë të ndryshëm që ndikojnë në përdorimin e internetit si, ku është gjetur se shumica e pjesëmarrësve (95%) kyçen në internet nëpërmjet telefonit dhe 5% nëpërmjet kompjuterit apo laptopit; 69% prej tyre kanë shprehur se kanë vazhdimisht internet në telefonin e tyre, kurse 99% kanë vazhdimisht internet në kompjuterit/laptopin në shtëpinë e tyre. Më shumë se gjysma e tyre (53%) kanë treguar se preferojnë që të qëndrojnë në rrjete sociale (53%), shikimin e videove dhe filmave (28%) dhe vetëm një pjesë e vogël e tyre me kërkim të informacioneve (8%), dëgjim të muzikës (6%) dhe luajtje të lojërave online (4%). Sa i përket rrjeteve sociale, Instagrami (43%) dhe Snapchati (37%) janë aplikacionet që përdoren më së shumti në mesin e të rinjve. Niveli mesatar i varshmërisë nga interneti është $M=35,74$, ai i vetmisë $M=39,45$ dhe i kënaqshmërisë nga jeta $M=25,5$.

Në hulumtim është gjetur ndërlidhje pozitive në mes të varësisë nga internet dhe vetmisë, ku vlera e significancës ka dalur të jetë $.00$, ndërsa vlera e korrelacionit $r= .19$, e cila ka konfirmuar hipotezën e parë të këtij hulumtimi. Në anën tjetër, hipoteza e dytë nuk është konfirmuar, ku nuk është gjetur ndërlidhje signifikante në mes të varësisë nga interneti dhe kënaqshmërisë nga jeta ($p >.05$). Hipoteza 3 dhe 4 janë konfirmuar, me ç'rast është gjetur ndërlidhje pozitive në mes të varësisë nga interneti me kohën (vitet) që kanë kaluar që nga kur personi ka filluar që të përdorë internetin ($r=.14$; $p<.05$) dhe me kohëzgjatjen, përkatësisht orët që një person i kalon gjatë ditës duke e përdorur internetin ($r=.37$; $p<.001$). Po ashtu, është gjetur se ka dallim signifikant në bazë të qëllimit të përdorimit të internetit me varësinë nga interneti ($p=.00$), ku niveli më i lartë i varësisë nga interneti është gjetur të jetë tek përdoruesit e internetit për të hyrë nëpër rrjete sociale, e cila ndiqet me shikimin e filmave dhe luajtjen e lojërave online. Në anën tjetër, është gjetur se nuk ekziston dallim signifikant për nga gjinia tek variabla e varësisë nga interneti, vetmia dhe kënaqshmëria nga jeta.

Në Kapitullin V është paraqitur diskutimi, ku është njoftuar se rezultatet e hulumtimit kanë konfirmuar hipotezën e parë, të tretë dhe të katërt të hulumtimit dhe se hipoteza e dytë dhe e pestë nuk janë konfirmuar. Po ashtu, në diskutim është paraqitur se rezultatet e këtij hulumtimi, bazuar në shqyrtimin e literaturës, mbështeten me rezultatet e hulumtimeve të mëparshme.

Të dhënat e këtij hulumtimi do të shërbejnë për ngritjen e vetëdijesimit të shoqërisë në përgjithësi, e të prindërve, mësimeve dhe adoleshentëve në veçanti, për pasojat e përdorimit të

pakontrolluar të internetit, i cili mund të çojë deri në varësi. Ky hulumtim mund të jetë shtytës për realizimin edhe të hulumtimeve tjera, ku do të shqyrtohen edhe faktorët tjerë që janë të ndërlidhura me varësinë nga interneti. Të dhënat e dalura nga ky hulumtim do të mund të shërbejnë si pikë nisje për hartimin e programeve të ndryshme parandaluese dhe preventive për eliminimin e rritjes së përdoruesve problematikë të internetit, si dhe të uljes së pasojave negative të tij.